

- **Rekrutimi i stafit mjekësor**

Rekrutimi i personelit mjekësor bazohet në Udhëzimin e MSHMS nr. 205, datë 09.04.2024 “*Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe disiplinës së mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet platformës elektronike*”.

Si më poshtë vijon link i Udhëzimit të sipërcituar;

<https://mjeke.shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/06/udhezim-2024-04-09-205.pdf>

- **Rekrutimi i stafit psiko-social**

Rekrutimi i personelit Psikolog/Punonjës social bazohet në Udhëzimin e MSHMS nr. 571, datë 07.10.2021 “*Për procedurat e rekrutimit të punonjësve Psikologë/Punonjës social në strukturat publike shëndetësore*”.

Si më poshtë vijon link i Udhëzimit të sipërcituar;

<https://mjeke.shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Udhezim-nr.-571-Per-procedurate-rekrutimit-per-punonjesit-psikolog-..pdf>

- **Rekrutimi i profesionistëve të shkencave mjekësore teknike.**

Rekrutimi i personelit infermieror bazohen në Udhëzimin nr. 204, datë 09.04.2024 “*Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet platformës elektronike*”, të Ministrisë përgjegjëse për Shëndetësinë.

Si më poshtë vijon link i Udhëzimit të sipërcituar;

<https://infermierepershqiperine.al/wp-content/uploads/2024/06/udhezim-2024-04-09-204.pdf>

- **Rekrutimit i stafit administrativ.**

Rekrutimi i personelit administrativ bazohet në dispozitat e Kodit të Punës dhe realizohet nëpërmjet konkurseve të hapura publike. Njoftimet për shpallje të vendeve vakante bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit dhe pranë Zyrës së Informacionit, në ambjentet e Marrëdhënieve me Publikun.

Për informacione të përditësuara mbi vendet vakante, lutemi të ndiqni linkun si më poshtë vijon;

<https://www.qsut.gov.al/vende-vakante/>

STRUKTURA E QSU “NËNË TEREZA”

Struktura e QSU "Nënë Tereza" përbëhet nga gjithsej 3,221 punonjës, të shpërndarë sipas kategorive :

1. Administrata, e cila përfshin një total prej 346 punonjësish, të angazhuar në funksione drejtuese, administrative dhe mbështetëse të institucionit;
2. Polet e Administrimit të Integruar, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të strukturës organizative me gjithsej 2,875 punonjës, të angazhuar drejtpërdrejt në ofrimin dhe mbështetjen e shërbimeve shëndetësore.

Në mënyrë të detajuar, personeli në Polet e Administrimit të Integruar është si vijon:

- Trupa mjekësore përbëhet nga 381 mjekë, të cilët kontribuojnë në ofrimin e shërbimeve diagnostikuese, terapeutike dhe akademike të mbështetur nga një kontingjent prej 400 mjekësh specializantë;
- Personeli teknik i shkencave mjekësore përfaqëson kategorinë me numrin më të lartë të punonjësve, me gjithsej 1,469 punonjës. Në këtë kategori bëjnë pjesë infermierë, përfshirë personelin e Task Force dhe logopedistët, si dhe teknikë imazherie, fizioterapistë, laborantë etj;
- Kategori të tjera të shërbimeve mbështetëse përbëhen nga 625 punonjës, të cilët kontribuojnë në garantimin e funksionimit të pandërprerë të shërbimeve të institucionit.